ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT PUBLIK

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Kundër: **Ministrisë së Punëve të Brendshme**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	**214-21-6523-1-2-1**
Nr i brendshëm	**214-21-063-121**

Sa i përket tenderit për:

Furnizim me material shpenzues ani Covid për stafin e MPB-se

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"Ardi" sh.p.k.
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

rr. "Nëna Terezë" nr. 187.

(Adresa)
Fushë Kosovë
(Vendi)

12000
(Kodi postar)

049888866
(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Fadil Demiri
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

ardishpk@hotmail.com
(Adresa elektronike)

08.02.2023
(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

SH.P.K. ARDI NRF: 600119186 FUSHE KOSOVE

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____
(Emri i avokatit)

_____
(Adresa e plotë)

_____
(Numri i Telefonit)

_____
(Numri i faks-it)

_____
(Adresa elektronike)

_____
(Data e parashtrimit të kërkesës)

_____
(Nënshkrimi dhe vula)

SH.P.K. ARDI NRF:600119166 FUSHË KOSOVË

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

- Me datën 30.09.2021 është publikuar B05 njoftimi për kontratë.
- Me datën12.11.2021 kemi pranuar letrën standarde për tenderuesin e eliminuar;
- Më datë 12.11.2021 është publikuar Njoftimi për dhënie të kontratës;
- Kriter për dhënie të kontratës ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulte.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

- Me datën 11.10.2021 Autoriteti Kontraktues ka publikuar në platformë procesverbalin e hapjes së ofertave.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** [ ]

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi i Ligjit për Prokurimin Publik
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi i LPP-së
Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë

SH.P.K. ARDI NR.: 600119186 FUSHË KOSOVË

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Më datë 24.01.2023, Autoriteti Kontraktues MPB ka marrë Vendim – Njoftim për anulimin e aktivitetit të prokurimit me numër 214-21-6523-1-2-1 të datës 24.01.2023 me titull "Furnizim me material shpenzues anti Covid për stafin e MPB-së", me arsyetim se AK duke u bazuar në vendimin e OSHP-së me nr. 681/21 të datës 25.07.2022 e anulon këtë aktivitet të prokurimit.

Kundër këtij Vendimi kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim në AK MPB, e cila më datë 01.02.2023 na ka dërguar Njoftimin për kërkesën për rishqyrtim me të cilën thekson se LPP nuk parasheh trajtimin e kërkesave për rishqyrtim të OE-ve në këtë fazë dhe se për aktivitetin e prokurimit në fjalë e duhet t'i referohemi vendimit të OSHP-së nr. 53/22 të datës 10.08.2022.

OE "Ardi" sh.p.k., konsideron se njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit 24.01.2023 dhe Njoftimi për kërkesën për rishqyrtim i datës 31.01.2023 janë në tërësi të kundërligjshme për arsyet si në vijim:

1. Si fillim, vendimi të cilit i referohet AK për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit me numër 681/21 i datës 25.07.2022 nuk ka të bëjë fare me këtë aktivitet të prokurimit. I njëjti ka të bëjë me një aktivitet krejt tjetër të prokurimit dhe për më tepër AK nuk ka dhënë fare arsye pse duhet të anulohet por vetëm ka theksuar se në bazë të vendimit të OSHP-së, e anulon këtë aktivitet të prokurimit. Për më tepër kjo lëndë 681/21 është në "proces" në OSHP, dhe ska të bëjë me këtë aktivitet prokurimi.

2. Më tutje, sqarojmë se OE "Ardi" shpk, lidhur me këtë aktivitet të prokurimit ka parashtruar ankesë në OSHP. Kjo e fundit duke vepruar sipas anekses ka marrë aktvendim PSH.nr.53/2022 të datës 10.08.2022 me të cilin e ka hedhur poshtë si jashtë afatit për shqyrtim këtë ankesë, me arsyetimin se OSHP një kohë nuk ka pasur Bord për shqyrtim të ankesave dhe tani kur Bordi ekziston ka kaluar afati ligjor për të vendosur për këtë ankesë.

3. OE "Ardi" shpk, kundër këtij vendimi ka parashtruar Padi me PROPOZIM PËR SHTYRJE TË AKTIT ADMINISTRATVI, në Gjykatën Komerciale, Departamenti për Çështje Administrative. Kjo e fundit më datë 14.11.2022 ka marrë aktvendim me të cilin ka aprovuar kërkesën për shtyrje të aktit administrativ të OE "Ardi" shpk, dhe ka shtyr ekzekutimin e vendimit të OSHP-së PSH.nr.53/2022 të datës 10.08.2022.

PROVË: Aktvendimi i Gjykatës Komerciale – Dhomat e shkallës së parë –

SH.P.K. ARDI NRF. 600119166 FUSHE KOSOVE

Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.1327/22 të datës 14.11.2022.

4. Rrjedhimisht, duke qenë se ekziston një vendim gjyqësor që ka shtyr ekzekutimin e vendimit të OSHP-së për këtë aktivitet të prokurimit PSH.nr.53/2022, AK Ministria e Punëve të Brendshme nuk ka të drejtë të anuloj këtë aktivitet të prokurimit.

5. Më tutje, AK ka theksuar se një dispozitë e Ligjit e kërkon anulimin. Mirëpo, nuk ka cekur asnjë dispozitë ligjore se në bazë të cili ligj e anulon këtë aktivitet të prokurimit.

6. Të gjitha këto argumente i kemi prezantuar me Kërkesën për Rishqyrtim, mirëpo AK nuk i ka trajtuar fare me arsyetimin se LPP nuk parasheh shqyrtimin e kërkesave për rishqyrtim. Ky konstatim i AK bije ndesh së pari me vendimin e lartcekur të Gjykatës dhe së dyti me vet Vendimin për anulim të aktivitetit të Prokurimit, ku AK me atë vendim, në faqen e fundit KA DHËNË KËSHILLËN JURIDIKE DUKE NA DHËNË MUNDËSINË QË TË PARASHTROJMË ANKESË. Ne këtë të drejtë ligjore dhe sipas këshillës juridike e kemi shfrytëzuar dhe kemi parashtruar Kërkesën për Rishqyrtim, ndërsa tani AK MPB thekson se nuk po u shqyrtokan në këtë fazë kërkesat për rishqyrtim.

PROVË: Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 24.01.2023.

7. Nuk është i saktë konstatimi i AK MPB se nuk ka dispozita ligjore që rregullojnë të drejtën për kërkesë për rishqyrtim/ankesë në këtë procedurë. Ky konstatim i AK bije ndesh me dispozitën e nenit 109 paragrafi 1 të Ligjit për Prokurimin Publik, ku përcaktohet se në çdo fazë të aktiviteteve të Prokurimit mund të parashtrohet ankesë, citojmë:

"Neni 109
Afatet për Dorëzimin e Ankesës
1. Ankesa mund të dorëzohet nga cilado palë e interesuar NË ÇDO FAZË TË AKTIVITETEVE OSE PROCEDURAVE TË PROKURIMIT dhe në lidhje me çfarëdo aktiviteti ose lëshimi të autoritetit kontraktues që supozohet të ketë bërë shkelje të këtij ligji."

8. Për më tepër, pas hapjes së tenderëve nuk lejohet që pa bazë ligjore të anulohet një aktivitet i prokurimit.

9. Si përfundim, OE "Ardi" sh.p.k., i propozon Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik, që në prani të këtyre argumenteve dhe provave të bashkangjitura të marrë këtë:

VENDIM

APROVOHET në tërësi si e bazuar ankesa e Operatorit Ekonomik "Ardi" sh.p.k., e parashtruar kundër Njoftimit për kërkesën për rishqyrtim të datës 31.01.2023 dhe Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Njoftimit për anulimin e aktivitetit të

SH.P.K. ARDI NRF: 600119186 FUSHE KOSOVE

prokurimit të datës 24.01.2023 të Autoritetit Kontraktues Ministrise se Puneve te Brendshme, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material shpenzues anti Covid për stafin e MPB" me numër të prokurimit 214-21-6523-1-2-1.

ANULOHEN në tërësi Njoftimi për kërkesën për rishqyrtim i datës 31.01.2023 dhe Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit të datës 24.01.2023 të Autoritetit Kontraktues Ministrise se Puneve te Brendshme, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me material shpenzues anti Covid për stafin e MPB" me numër të prokurimit 214-21-6523-1-2-1 **ashtu që** ky aktivitet i prokurimit kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje te Autoriteti Kontraktues Ministria e Punëve të Brendshme.

Fushë Kosovë, 08.02.2023

SH.P.K. ARDI NRF: 600119166 FUSHË KOSOVË

Operatori Ekonomik:

"Ardi" sh.p.k.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e supozuara kanë shkaktuar dëmtim të imazhit të kompanisë kur merret parasysh afarizmi jonë në tregun global. Gjithashtu na është shkaktuar dëm material-financiar.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*